



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM
Nr. 217, Datë 20.12.2019

MBI
LICENCIMIN E SHOQËRISË “ELVA 2001” SHA, NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “MIVAS”, ME KAPACITET
TË INSTALUAR 1940 KW

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37 pika 2, gërma” a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5 pika 1, gërma “a” dhe nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, si dhe nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 20.12.2019 mbasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga shoqëria “ELVA 2001“ shpk, si dhe pasi shqyrtoi relacionin nr.115/4 prot, datë 12.12.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “ELVA 2001” shpk, për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie, nga Hec “MIVAS” me kapacitet të instaluar 1940 kW.

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me Vendimin nr. 151, datë 14.10.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “ELVA 2001” sha, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “MIVAS” me kapacitet të instaluar 1940 kW.
- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje u krye njoftimi në median e shkruar, me shkresën nr. 32/42, datë 15.10.2019, dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “ELVA 2001” sha.
- ERE me shkresën nr. 656 Prot, datë 21.10.2019, iu drejtua shoqërisë “ELVA 2001” sha duke i njoftuar vendimin për fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar, i cili konsistonte në:

- **Neni 9, pika 2, gërma “g”** (dokumenta që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti)
- **Neni 9, pika 3, gërma “c”** (dokumenta që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit)
- **Neni 9, pika 4.1.1,** (të dhëna teknike për HEC, pika 3, pika 8, pika 11, pika 16, pika 19)
- **Neni 9, pika 4.1.4, gërma e** (dokumentacioni tekniko-ekonomik).
- Shoqëria “ELVA 2001” sha, me shkresën e protokolluar në ERE nr. 656/1 Prot, datë 04.11.2019, ka përcjellë në ERE dokumentacionin e kërkuar.
- Duke konstatuar se nuk ishin shteruar të gjitha kërkesat për dokumentacionin e munguar, ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 656/2 prot, datë 12.11.2019 për plotësimin e informacionit dhe dokumentacionit të munguar.
- Shoqëria “ELVA 2001” sha, me shkresën protokolluar në ERE me numër 656/3, datë 20.11.2019, ka përcjellë në ERE dokumentacionin e kërkuar.
- Shoqëria “ELVA 2001” sh.a., është një subjekt tregtar i krijuar me vendimin Nr. 25441 të Gjykatës së Rrethit, Tiranë, datë 15.03.2001, në zbatim të ligjit nr. 7512, datë 10.08.1991, dhe mban numër identifikimi (NUIS) K12809402J.
- Shoqëria “ELVA 2001” sha është mbajtëse e “Miratimit përfundimtar për ndërtimin e objektit, hidrocentralit "Mivas", me kapacitet prodhues 1940 kW, në pellgun ujëmbledhes të lumit Tomoricës, Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan, me nr. 2657/2 Prot, datë 27/12/2017”, mbështetur në pikën 2 të nenit 49 të Ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndryshuar, si dhe në VKM-në nr. 822, datë 07.10.2015 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjise elektrike, që nuk janë objekt koncesioni" i ndryshuar.
- Shoqëria ka nënshkruar Kontratën me Nr. 5 Rep, Nr.3/3 Kol, datë 25.01.2018 me Ministrinë e Infstrukturës dhe Energjisë (MIE). Kohëzgjatja e kontratës do të jetë 49 vjet, me të drejtë ripërsëritje. Referuar kësaj kontrate, për afatet e vënies në punë të veprës, mbajtësi i miratimit merr përsipër të vënë në punë hidrocentralin brenda 21 (njëzet e një) muajve nga data e marrjes së të gjitha lejeve për fillimin e punimeve, siç është parashikuar në grafikun e punimeve të paraqitur në Aneksin 2, bashkëlidhur kontratës.
- Afati i aplikimit në përputhje me rregullat e përcaktuara nga strukturat shtetërore, për pajisjen me lejet e nevojshme është jo më shumë se 12 muaj nga data e hyrjes në fuqi të Kontratës. Rezulton se shoqëria ka vijuar me aplikimet për pajisjen me lejet në institucionet përkatëse.
- Periudha e vlefshmërisë së lejes së shfrytëzimit të ujit është deri në datën 16.11.2022
- Shoqëria bën me dije se i ka të gjitha mundësitë për të vënë në punë Hec-in brenda vitit 2019.
- Aplikimi i shoqërisë “ELVA 2001” sha, plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në *“Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”* si më poshtë:
 - **Formati i aplikimit** (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- **Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor** (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f” dhe “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- **Dokumentacioni financiar dhe fiskal** (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- **Dokumentacioni teknik** (neni 9, pika 4.1.1, pika 4.1.2, pika 4.1.3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”; pika 4.1.4 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”; pika 4.1.5 gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Në kuptim të nenit 38 të ligjit nr.43/2015 “Për Sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, ERE përcakton kushtet që duhet të përmbushen për marrjen e çdo licence, duke marrë në konsideratë, ndër të tjera: *a) afatin e vlefshmërisë së licencës, i cili për veprimtarinë e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes nuk mund të jetë më shumë se 30 vjet;*

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “ELVA 2001” sha, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Mivas”, me kapacitet të instaluar 1940 Kw, për një afat 30-vjeçar.
2. Shoqëria “ELVA 2001” sh.p.k të depozitojë në ERE çdo dokument/leje që i nënshtrohet procedurës së rinovimit, nga institucionet që i lëshojnë ato, jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të afatit të parashikuar në këto dokumenta/leje.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brënda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petril AHMETI